

SHENIMET SHPJEGUESE

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2 i përmirësuar Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte te percaktuara ne SKK 2 te përmirësuar. Radha e dhenies se spjegimeve duhet te jete :

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

A I Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligjit 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2 Kuadri kontabel i aplikuar : Stndartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2)
- 3 Baza e pergatitjes se PF : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SSK 1)
- 4 Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e P.F. : (SKK 1)
 - a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet,pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.
 - b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevojte nderprerjen e aktivitetit te saj.
 - c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
 - d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te gene te qarta dhe te kuptushme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
 - e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
 - f) BESUSHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhteme :
 - Parimin e paraqitjes me besnikeri
 - Parimin e perparetise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
 - Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
 - Parimin e maturise pa optimizem te teperuar,pa nen e mbivleresim te qellimshem
 - Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
 - Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
 - Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II Politikat kontabël

Per percaktimin e koston se inventareve eshte zgjedhur metoda "FIFO" (hyrje e pare , dalje e pare).(SKK 4)

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto. (SKK 5; 11)

Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua,kostot e huamarrjes (dhe interesat) eshte metoda e kapitalizimit ne koston e aktivit per periudhen e investimit.(SKK 5)

Per vleresimi i mepaseshem i AAM eshte zgjedhur modeli i koston duke i paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5)

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5) njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit te ndertesave metoden lineare dhe per AAM te tjera metoden e amortizimit mbi bazen e vlefes se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdorur te njellojta me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

- Per ndertesat me 5 % te vlefes se mbetur
- Kompjutera e sisteme informacioni me 25 % te vlefes se mbetur
- Te gjitha AAM te tjera me 20 % te vlefes se mbetur

Per llogaritjen e amortizimit te AAJM (SKK 5) njesia ekonomike raportuese ka percaktuar si metode te amortizimit metoden lineare me normen e amortizimit me 15 % ne vit.



SHENIME SHPJEGUESE; Per periudhen 01 Janar deri me 31 Dhjetor 2018.

Ne kete aneks paraqiten informacionet shpjeguese ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare te njesise ekonomike Superior Klima sh.p.k.

Njesia ekonomike Superior Klima sh.p.k e krijuar me date 12.05.2009, ushtron aktivitetin e saj ne fushen Import-Export, Tregeti me shumice e pakice te mallrave, pajisjeve, pjeseve te nderrimit per kondicioner ne qytetin e Tiranes, me adrese Njesia Bashkiake nr.5, Rruga "Sulejman Delvina", Pallati "Melrose", Dyqani nr.2, Kati 1.

Per periudhen 01 Janar 2018 deri me 31 Dhjetor 2018 jane pergatitur dhe paraqitur paketa e plote e pasqyrave financiare, te cilat japin pamjen te vertete dhe te drejte te pozicionit financiare, performances financiare dhe fluksit te parase gjate kesaj periudhe.

Pergatitja dhe paraqitja e tyre, e cila eshte pergjegjesi e Drejtimit te subjektit, eshte realizuar mbeshtetur ne Ligjin nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit(KKK). Gjuha e perdorur eshte gjuha shqipe. Monedha e perdorur eshte monedha Leke. Rrumbullakime te vlerave nuk ka. Ngjarjet dhe trasaksionet jane evidentuar gjate gjithe periudhes ushtrimore ne perputhje me SKK nr 1 Kuadri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare dhe SKK nr 2 Paraqitja e pasqyrave financiare si dhe cdo standard tjetër kombetar ne perputhje me natyren e ngjarjeve apo trasaksioneve te cilat ne menyre te hollesishme do te jepen ne vijim te informacioneve shpjeguese.

❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren BILANC.

Paraqitja e kesaj pasqyre eshte mbeshtur ne paketen e plote te standardeve te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit. Ne vijim do te jepen informacionet shpjeguese per zerat perberes te saj.

I. Informacione Shpjeguese per AKTIVET.

Totali i aktiveve te paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **948,405,435 leke** detajimi nepermjet informacioneve shpjeguese i te ciles paraqitet si vijon;

✚ Informacione shpjeguese te AKTIVE AFATSHKURTRA

Aktiveve afatshkurtra jane paraqitur ne vleren **904,734,715 leke** te cilat jane te perbera nga;

1. Aktive monetare 1,523,119 leke. Ky ze eshte paraqitur ne pasqyre duke u mbeshtetur edhe ne SKK nr 12 *Efektet e ndryshimeve te kurseve te kembimit* dhe paraqet tepricen e llogarise Arka dhe tepricen e llogarise banke, ne monedhen leke dhe euro ne date 31.12.2018. Kursi i kembimit eshte perdorur ne menyre sistematike gjate gjithe ushtrimit te aktivitetit te subjektit per ngjarjet e trasaksionet te cilat jane kryer ne monedha te huaja.

2. Te drejta te arketueshme te cilat jane paraqitur ne vleren **711,796,761 leke** dhe eshte e perbere nga;



Zeri, Nga aktiviteti i shfrytëzimit ne vleren **296,013,518 leke**, i cili eshte evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 3 ne te cilen përfshihen të gjitha të drejtat e krijuara gjate periudhes ushtrimore ndaj klientave për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, te paraqitura me vleren neto te realizueshme.

Zeri, Të tjera ne vleren **415,783,243 leke** perfshin te gjitha parapagimet e furnitoreve per vitin 2018.

Zeri, Kërkesa ndaj tatim taksave ne vleren **0 leke**, pëfshihen të gjitha të drejtat e njësisë ndaj të tretëve, te krijuar gjate periudhes ushtrimore.

3. Inventari i paraqitur ne vleren **183,859,462 leke**, i cili eshte i perbere vetem prej;

Zeri Mallra ne vleren **102,453,556 leke** jane njohur dhe vleresuar ne perputhje me SKK nr 4 *Inventaret*. Kostoja e inventarit eshte vleresuar me metoden e kosos mesatare te ponderuar.

Zeri Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte ne vleren **63,411,121 leke**, pasqyron vleren e plote te ndertimit.

Zeri Parapagimet per inventar ne vleren **17,994,785 leke** perben parapagimet e furnitoreve per mallra dhe sherbime qe do te blihen ne periudhen e ardhshme ushtrimore.

Zeri Shpenzime të shtyra ne vleren **7,555,373 leke** perben tarifen e aplikimit per leje ndertimi qe do te shperndahet ne periudhat e ardhshme ushtrimore.

✚ Informacione shpjeguese te **AKTIVET AFATGJATA**

Aktivitet afatgjata jane paraqitur ne Vleren Kontabel Neto **43,670,720 leke**. Ato jane evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 5 Aktivitet afatgjata materiale dhe aktivitet afatgjata jomateriale. Paraqitja e tyre eshte bere nepermjet politikës kontabel Metoda e Kosos. Perberja e ketij zeri paraqitet si vijon;

1. Aktive afatgjata materiale jane ne vleren **43,670,720 leke** dhe eshte i perbere zeri *Toka dhe ndërtesa* ne vleren **17,634,189 leke**, zeri *Impiante dhe makineri* ne vleren **11,050,389 leke** dhe zeri *Të tjera Instalime dhe pajisje* ne vleren **14,986,142 leke**. Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur dhe eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren **6,499,131 leke**. Ne te jane te perفشire elementet e meposhtem;

Nr. Llogarie	Emertimi i Llogarise	Monedha	Debi	Kredi
2121	Ndertesat (zyra)	LEK	15,000,000	
2127	Rregullime te pergjithshme	LEK	1,675,686	
2128	Rregullime te pergjithshme (objekti ne ndertim)	LEK	5,780,289	
213	Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente dhe vegla pune	LEK	8,829,791	
215	Mjete transporti	LEK	10,160,670	
2181	Mobilje dhe pajisje zyre	LEK	7,737,205	
2182	Pajisje informative	LEK	3,790,757	
2188	Të tjera	LEK	14,196,554	
2812	Për ndërtesat	LEK		3,585,246
28121	Per ndertesat (zyra)	LEK		893,751
28127	Per rregullime te pergjithshme	LEK		342,789

2813	Për instalime teknike, makineri, pajisje, instrumenta e vegla	LEK		3,975,293
2815	Për mjetet e transportit	LEK		3,964,779
28181	Per mobilje dhe pajisje zyre	LEK		3,374,162
28182	Per pajisje informative	LEK		2,035,783
28188	Per te tjera	LEK		5,328,430
		Totali:	67,170,953	23,500,234
			43,670,720	

II. Informacione Shpjeguese per DETYRIMET.

Detyrimet e paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **963,192,083 leke** dhe perbehet nga detyrime te periudhave afashkurtra dhe afatgjata. Detajimi jepet nepermjet informacioneve shpjeguese si vijon;

✚ Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATSHKURTRA

Detyrimet afatshkurtra jane paraqitur ne total ne vleren **440,390,643 leke**, dhe jane te perbera nga detyrimet ndaj furnitoreve, punonjesve, detyrime ndaj shtetit per tatime dhe taksa si dhe hua te tjera.

- Arkëtime në avancë për porosi ne vleren **95,324,591 leke** perbejne paradheniet per punime nga klientet e njesise ekonomike ne vleren **69,222,955 leke** si dhe arketime ne avance te klienteve ne vleren **26,101,636 leke**.

- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **335,001,463 leke** paraqesin detyrimin ndaj furnitoreve te ndryshem te njesise ekonomike ne fund te vitit 2018.

- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore ne vleren **849,928 leke** perbejne detyrimin per sigurimet shoqerore dhe shendetsore per muajin Dhjetor 2018 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Sigurime Shoqerore	431	849,928

- Të pagueshme për detyrimet tatimore ne vleren **9,214,661 leke** perbejne detyrimin per muajin Dhjetor 2018 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Tatim fitimi	444	589,658
Shteti- TVSh për tu paguar	4453	8,597,900
Tatim mbi te ardhurat personale	447	9,103
Tatim qera	447	18,000

✚ Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATGJATA

Detyrimet afatgjata jane paraqitur ne total ne vleren **522,801,440 leke** perbejne detyrimet e njesise ekonomike per huate e marra nga Institucionet e Kreditit (Bankat).

III. Informacione Shpjeguese per KAPITALIN



Kapitali i paraqitur ne vleren **(14,786,649) leke** dhe eshte i perbere nga zerat Kapital i nenshkruar, Fitimet e pashperndara dhe Fitim / Humbje e vitit, detajimi i te cilave do te jepet ne informacionet shpjeguese.

1. Informacione shpjeguese te zemit KAPITAL

Ne kete ze jane paraqitur kapitali i kontribuar nga aksionerët ose nga ortakët dhe jane përmbledhur tepricat kreditore të llogarive vijuese:

Emertimi	Ref	Vlera
Kapitali i paguar,	101	5,380,000

Ne perputhje me aktin e themelimit date 12 Maj 2009 dhe vendimin per shtim kapitali nga aksioneret kapitali i kontribuar eshte i perbere nga Kuota ose aksione, gjithsej 100 pjese me vlere nominale 53,800 leke.

2. Informacione shpjeguese te zemit FITIME TE PASHPERNDARA

Zeri *Fitime te pashperndara* paraqitet ne vleren **(32,300,314) leke** dhe perfshin humbjet që njësia ekonomike ka akumuluar nga periudhat paraardhëse.

3. Informacione shpjeguese te zemit FITIM / HUMBJE E VITIT

Zeri *Fitim / Humbje e vitit* paraqitet ne vleren **12,133,666 leke** dhe paraqitet rezultati i periudhës rrjedhese ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi eshte zbritur tatimi mbi fitimin.

❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve eshte paraqitur bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres. Ne kete periudhe ushtrimore ka rezultuar nje fitim ne vleren **12,133,666 leke**.


Zeri Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit te paraqitura ne pasqyre evidenton te gjitha shitjet e realizuara me vleren e tyre neto **464,795,311 leke**.

Zeri Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme te paraqitura ne vleren **369,894,226 leke** perfaqesojne koston e mallrave te blera per qellime rishitje. Politika kontabel eshte paraqitur me larte ne zerin *Mallra per shitje* (Inventar).

Zeri Shpenzime të personelit i cili eshte i paraqitur ne vleren **34,533,494 leke** perfaqeson:

1. Shuma *Paga dhe shpërblime* gjate periudhes ushtrimore 01.01-31.12.2018 ne vleren **29,572,258 leke**
2. Shuma *Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)* gjate periudhes ushtrimore 01.01-31.12.2018 ne vleren **4,961,236 leke**

Nga keto vlera vetem shuma **0 leke** eshte ende e papaguar e cila eshte pasqyruar ne bilanc, dhe per te cilen jane dhene informacione shpjeguese me larte.



Zeri Shpenzime të tjera shfrytëzimi te cilat janë te paraqitura ne vleren **20,752,777 leke** perfaqesojne shpenzimet te cilat janë kryer per zhvillimin e aktivitetit te njesise ekonomike, dhe perfaqeson zera te shpenzimeve si Furnitura, Taksa te ndryshme, shpenzime te tjera rrjedhese etj.

Zeri Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit) te cilat janë te paraqitura ne vleren **10,092,997 leke** perfaqesojne te ardhurat nga interesat bankare si dhe diferencat pozitive nga kurset e kembimit.

Zeri Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit) te cilat janë te paraqitura ne vleren **(28,806,401) leke**, perfaqesojne shpenzimet qe vijne nga interesa bankare, interesa kredie, overdrafti etj.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren CASH FLOW.**

Ne pasqyren e flukseve monetare janë paraqitur flukset hyrese dhe dalese te mjeteve monetare në njësinë ekonomike gjatë periudhës korrente kontabël. Paraqitja është bere sipas metodes indirekte.

Gjate periudhes kontabel ka rezultuar;

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **149,096,528 leke**. Fluksi pozitiv ka ardhur pasi flukset dalese te mjeteve monetare per kryerjen e shpenzimeve si psh, paga, detyrime per kontribute te sigurimeve dhe te tatim-taksave janë me te ulta se flukset hyrese te mjeteve monetare gjate ushtrimit normal te aktivitetit nga njesia ekonomike.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit ne vleren **(9,685,088) leke** i cili ka ardhur si rezultat i blerjes dhe shitjes se aktiveve afatgjate materiale.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit ne vleren **(143,703,330) leke** i cili ka rezultuar nga shlyerja e huamarrjeve afatgjata nga Institucionet e Kreditit.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT .**

Ndryshimet ne zerin Kapital kane ardhur si rezultat;

1. Fitim / Humbje e vitit ne vleren 12,133,666 leke.

Informacionet shpjeguese per zerat e mesiperm janë dhene ne pasqyren e Bilancit.

Drejtuesi

Altion Memushi

